

Përshkrimi i kursit

Ofrimi i furnizimit me ujë, në cilësinë e duhur dhe brenda parametrave të nevojshme, duke zbatuar kështu standardet dhe rregulloret



ekzistuese, është misioni dhe përgjegjësia kryesore e Shoqërive Ujësjiellës Kanalizime.

Një sistem furnizimi me ujë të pijshëm konsiderohet i sigurt kur ai nuk përmban organizma patogjene që shkaktojnë sëmundje, kimikate toksike, si kur uji është i mirë në shije dhe në dukje, duke qënë kështu i pranueshëm për konsumatorët, si ata familjarë dhe industrial.

Ky kurs trajnimi do t'ju shërbejë punonjësve të Shoqërive Ujësjiellës Kanalizime të njohin transformimet kimike, fizike dhe biologjike të ujit kur ai hyn dhe qarkullon në rrjetin shpërndarës. Gjithashtu pjesëmarrësit do të mësojnë dhe mbi praktikat e monitorimit dhe mbikqyrjes së rrjetit.

Proçesi i dezinfektimit dhe aplikimi i klorit do të trajtohen gjithashtu në mënyrë të zgjeruar, gjatë këtij kursi.

Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjiellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për drejtorët e departamentit teknik dhe të shpërndarjes, inxhinierët e mirëmbajtjes dhe të shfrytëzimit, si dhe laborantët.

Kursi është me interes dhe për drejtuesit e impianteve të ujit të pijshëm dhe kimistët, për zyrtarë të shëndetit publik, apo institucione të tjera të ngjashme.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Identifikoni burimin dhe llojet e ndotësve që futen në sistemin shpërndarës të ujit;
- Zhvilloni një program mbikqyerje për sistemin e shpërndarjes së ujit;
- Realizoni një program për monitorimin e cilësisë së ujit në sistemin shpërndarës;
- Parandaloni lidhjet e kryqëzuara dhe të zhvilloni një program për kontrollin e tyre;
- Njihni faktorët që ndikojnë në dezinfektim dhe disa nga metodat e dezinfektimit;
- Kryeni dezinfektimin e pompave, tubacioneve të ujit, dhe objekteve të ruajtjes;
- Identifikoni pikat e aplikimit të klorit.

Metoda e trajnimit



Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthurura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes së leksioneve

dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë raste konkrete duke u angazhuar në zhvillimin e ushtrimeve dhe punëve laboratorike.

Materialet e kursit

Si pjesëmarrës në këtë kurs, ju do të pajiseni me Manualin e Trajnimit për Cilësinë e Ujit në Sistemin e Shpërndarjes. Përpos kësaj, ju do të pajiseni me çertifikatë e cila dëshmon pjesëmarrjen tuaj në këtë trajnim.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB: 22,000 lekë për person

Jo-anëtarët: 25,000 lekë për person

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.

FORMULAR REGJISTRIMI

Emër Mbimër _____

Datëlindja _____

Institucioni _____

Pozicioni _____

Edukimi _____

Celular _____

E-mail _____

Adresa _____

Ju lutem, plotësoni këtë formular dhe dërgojeni në adresën e e-mailit training@shukalb.al.
Pagesën mund ta derdhni në llogarinë bankare të Shoqatës si më poshtë, duke specifikuar emrin tuaj dhe qëllimin e transfertës:

Banka: PROCREDIT, Dega Tiranë

Emri i Llogarisë: Shoqata e Ndërmarrjeve Ujësjiellës Kanalizime të Shqipërisë

Numri i Llogarisë: 10-831379-00-01

IBAN: AL 95209111080000108313790001

***Shënim:** Pjesëmarrja juaj në këtë aktivitet duhet të konfirmohet nëpërmjet e-mailit, telefonit apo postës.*

Nëse ju konfirmoni dhe mungoni në këtë trajnim pa paparalajmëruar minimalisht 3 ditë përpara, atëherë shuma e plotë e pagesës do tju mbahet.